

KËRKESË
Nr. 130/6, datë 25.4.2023

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësim shpall kërkesën “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Zgjerimi i varrezave publike të qytetit Gjirokastrë”.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Bashkia Gjirokastrë.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, për pasuritë e llojit “truall” bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Bashkinë Gjirokastrë, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 18,924,850 (tetëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e njëzet e katër mijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM TË SHPRONËSIMEVE
Egra Ibrahim

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE TË TË CILËVE
SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK, NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT “ZGJERIMI I VARREZAVE
PUBLIKE TË QYTETIT GJIROKASTËR”

Nr.	Pronari			Të dhëna hipotekare							Vlerësimi për shpronësim				
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteu	Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Volumi	Faqe	Truall			Vlera totale (lek)	Shënime
											Sipërfaqja (m ²)	Çmimi (lek/m ²)	Vlera (lek)		
	A	B	C	C	Ç	D	E	F	J	K	R	S	T	Y	z
1	Javer	Osman	Zani	Gjirokastrë	8543	25/37	Truall	18722	4	15	3890	4865	18,924,850	18,924,850	Konfirmuar nga ASHK-ja
SHUMA														18,924,850	